



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No.	1299	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 06
Data / Datum / Date:	16.07.2020	Pejë / Poë

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Senati

Ref. Nr.

Pejë

Në bazë të nenit 42, 47, 48, pika 1.8 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ – së, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.06.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET Rregullorja për punën e Komisionit për ankesa dhe parashtrës në kuadër të Senatit të Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit në Senat.

Vendimi t'i dërgohet;

- Rektorit,
- Anëtareve të Senatit,
- Sekretarit të Përgjithshëm,
- Dekanëve të Njesisë Akademike,
- Zyrës për komunikim më publikun
- Arhivës.



Kryesuesi i Senatit:
Prof. Dr. Fadil Millaku

Fadil Millaku
Rektor i UHZ – së



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	1249	Nr. i faq/ Br. str / No. pg	06
Data / Datum / Dato:	16 07 2020	Pejë / Poć	

Adresa; Rruga e UCK-se, 30000 Peje Republika e Kosovës, Nr tel + 381 039 432 270, info@unhz.eu

Rregullore e punës së Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa

Pejë, 2020

UNIVERSITETI

Në bazë të nenit 42 dhe 47, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2020, aprovoi:

RREGULLOREN E PUNËS TË KOMISIONIT PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave dhe parashtresave, punën, organizimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore parasheh qartë paraqitjen, shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me të gjitha ankesat dhe parashtresat e paraqitura në Komisionin e Ankesave dhe Parashtresave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 3

E drejta e ankesës

3.1. Të gjitha palët e pakënaqura me vendimet e Senatit të UHZ, mund të parashtrojnë ankesë në afatin prej 15 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të vendimit zyrtar në përputhje me dispozitat e Statutit të UHZ-së, neni 185 paragrafi 3.4 dhe të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

3.2. Palët mund të paraqesin ankesë nëse vendimi është nxjerrë si rezultat i:

3.2.1. Shkeljes së dispozitave procedurale;

3.2.2. Zbatimit të gabuar të ligjit material apo rregullat materiale të zbatueshme;

3.2.3. Nëse vendimi nuk zbatohet në faktet dhe provat e prezantuara.

Neni 4

Procedurat dhe shqyrtimi i ankesave

Pranimi i ankesave dhe parashtresave, drejtuar Organeve të UHZ-së, bëhet nga Zyra e Protokollit e Rektoratit duke u regjistruar në protokoll brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

4.1. Nëse Komisioni vendos se ankesa nuk i plotëson kriteret sipas Statutit, apo/dhe ka mungesë të fakteve/evidencës në mbështetje të ankesës, njofton me shkrim brenda 7 ditësh kalendarike se ankesa nuk do të shqyrtohet, duke dhënë arsyet për vendimin.

4.2. Komisioni do ti Rekomandoje Senatit për aprovimin apo refuzimin e ankesës apo parashtresës që e ka pranuar, brenda 15 ditësh kalendarike nga pranimi i ankesës dhe dokumentacionit mbështetës,



Neni 5

Emërimi, përbërja dhe mandati i anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave

- 5.1. Emërimi, përbërja dhe mandati i anëtarëve të Komisionit përcaktohet me Vendim të Senatit të UHZ.
- 5.2. Mandati i Komisionit lidhet me mandatin e Senatit, Në rast të përfundimit të mandatit apo largimit, zëvendësimi i ndonjë anëtari/je të Komisionit bëhet sipas të njëjtës procedurë si në pikën 1 të këtij neni.

Neni 6

Zgjedhja e kryetarit të Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave

- 6.1. Kryetari i Komisionit zgjidhet njëkohësisht me anëtarët e Komisionit me Vendim nga Senati.
- 6.2. Në rast të largimit apo shkarkimit të Kryetarit të Komisionit, bëhet sipas të njëjtës procedurë si në pikën 1 të këtij neni.

Neni 7

Kompetencat e Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave

Në përputhje me Statutin e UHZ-së dhe dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Ligji Nr. 05/L-031, datë 25 maj 2016), Komisioni i Ankesave dhe Parashtresave fuqizohet të marrë vendime nëse një ankesë ose parashtresë është e justifikueshme dhe e bazuar, lidhur me :

1. Shkeljen e rregullave dhe procedurave të vendim-marrjes nga ana e Senatit apo Këshillave të NA të UHZ-së;
2. Shqyrtimin e ankesave që i drejtohen Senatit dhe lidhen me ligjshmërinë e konkurseve publike të UHZ-së për emërimin / avancimin e pranimit të stafit akademik të rregullt dhe me kohë jo të plotë;
4. të gjitha ankesat dhe parashtresat tjera kundër vendimeve të këshillave të njësive akademike dhe të Dekanëve.

Neni 8

Mbledhjet e Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave

- 8.1. Mbledhjet e Komisionit i thërret Kryetari i Komisionit;
- 8.2. Në mungesë të Kryetarit të Komisionit, mbledhja do të udhëhiqet nga anëtari/ja më i/e vjetër i/e komisionit, i/e cili/a edhe do t'i nënshkruaj vendimet e mbledhjes përkatëse në emër të Komisionit.
- 8.3. Komisioni do të mbajë mbledhje sipas nevojës, përkatësisht paraqitjes së ankesave apo parashtresave.

Neni 9

Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

- 9.1. Shërbimet e Sekretarisë në Komision i kryen një zyrtar administrativ që caktohet nga

ZKA më kërkesë të komisionit.

9.2. Agjenda e takimit përmban ankesat dhe parashtresat e dhëna nga Komisioni.

9.3. Kryetari i Komisionit e hapë, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen, në përputhje me rendin e ditës dhe agjendës të komisionit,

9.4. Në fillim të mbledhjes kryetari konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hapë

diskutimin rreth rendit të ditës, dhe konstaton miratimin e rendit të ditës. Rendi i propozuar i ditës duhet të vendoset me kohë para fillimit të mbledhjes.

9.5. Në mbledhje duhet të jene prezent të gjithë anëtarët e Komisionit, përkatësisht shumica absolute.

9.6. Kryetari i jep fjalën diskutuesit/es, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Vendimmarrja

10.1. Për marrjen e vendimeve të Komisionit duhet të jenë prezent shumica absolute të anëtarëve të Komisionit.

10.2. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Komisionit.

10.3. Para se të votohet, kryesuesi/ja formulon propozimin e vendimit lidhur me ankesën ose parashtresën.

10.4. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas ankesës ose parashtresës, Komisioni merr vendim lidhur me to.

10.5. Votimi bëhet i hapur me ngritje dore.

10.6. Rekomandimi duhet të jetë i qartë në formë të shkruar dhe i argumentuar mirë para se ti dorëzohet Senatit të UHZ-së për procedurë të mëtejme.

Neni 11

Mbajtja e procesverbalit

11.1. Në çdo mbledhje të Komisionit mbahet procesverbal. Procesverbalit nënshkruhet nga kryetari/ja/kryesuesi/ja dhe procesmbajtësi/ja.

11.2. Procesverbalit duhet të përmbajë këto elemente:

- vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
- rendin e ditës;
- listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;
- të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe
- çështje tjera relevante ose materiale të shqyrtuara gjatë rrjedhës së mbledhjes.

11.3. Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks.

11.4. Procesverbali ruhet ne arkiv të Komisionit.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

Për të gjitha çështjet që nuk mbulohen me Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" ne Peje, për rregulloren përkatëse do te zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat me te përshtatshme te Ligjeve te aplikueshme ne Kosove, Ligji për Arsimin e Larte dhe aktet tjera nënligjore te AL ne Kosove dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji Nr. 05/I_-031 25 maj 2016).

12.2. Kjo rregullore hyn ne fuqi ditën e miratimit nga Senati i UHZ-së.

Pejë, 30.06.2020

Rektori:

Prof.Dr. Fadil Millaku

